UKaid
from the British people

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

BAROMETRI KOMBËTAR I LIRISË SË MEDIAS NË SHQIPËRI

2020



Barometri Kombëtar i Lirisë së Medias në Shqipëri

Për vitin 2020

Tiranë, Tetor 2021

Pyetësori dhe Metodologjia: Znj. Fatjona Mejdini, Eksperte e medias

Zbatimi i metodologjisë dhe përgatitja e raportit: Z. Vladimir Karaj, Gazetar
Znj. Ola Mitre, Gazetare

Redaktim ligjor: Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, KShH

Znj. Ilda Dushi (Çukaj), Koordinatore Projekti, KShH

Publikuar nga: Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Rruga "Brigada e VIII", Kulla "Tekno Projekt", Shkalla 2, Apartamenti 10, Kati 6

© 2021 Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Ky raport u hartua në kuadër të projektit "Forcimi i Standardeve të Integritetit të Medias në Shqipëri' mbështetur nga Ambasada Britanike në Tiranë dhe zbatuar nga East -West Management Institute.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikepamjet e East-West Management Institute dhe/ose Ambasadës Britanike në Tiranë.

Tabela e lëndës

1. Hyrje ***3***

2. Përmbledhje ekzekutive ***5***

3. Metodologjia ***10***

4. Respektimi i të drejtave të gazetarëve në vendin e punës ***14***

4.1. Informaliteti në punë 14

4.2. E drejta për pushime javore dhe vjetore 15

4.3. Bullizmi/tallja në vendin e punës 16

4.4. Ngacmimet seksuale në vendin e punës 17

4.5. Nevoja për krijimin e Sindikatës së Punonjësve të Medias 17

5. Liria profesionale ***19***

5.1 Kërcënimet për shkak të punës 19

5.2. Stresi dhe situatat traumatike 20

5.3. Censurë dhe vetëcensurë 20

6. Vlerësimi i lirisë së medias ***23***

6.1. Perceptimi mbi lirinë e medias dhe tendenca me vitet e kaluara 23

6.2. Ngjarjet (faktorët) ndikues 24

6.3 Gazetaria Cilësore 25

6.4 Aksesi në Gjykatë 25

7. Rekomandime ***27***

Aneks 1 - Pyetësor ***30***

1. Hyrje

Në përputhje me misionin e tij, për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) ndërtoi dhe zbatoi "Barometrin Kombëtar të Lirisë së Medias në Shqipëri për vitin 2020", i pari i këtij lloji në vendin tonë që është kryer nga gazetarët për gazetarët. Barometri përpunon dhe analizon nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, të dhënat e përftuara nga një sondazh i realizuar me gazetarët, për situatën e kushteve të tyre të punës, lirisë profesionale dhe perceptimet e tyre mbi lirinë e medias në tërësi. Vlen të theksohet se të dhënat janë mbledhur nga dy ekspertë në fushën e gazetarisë dhe komunikimit, duke garantuar anonimatin e të anketuarve që kanë shfaqur interes për Barometrin.

Me rënien e regjimit totalitar, liria e shprehjes u garantua fillimisht në vitin 1993, me ligjin nr.7692, datë 31.03.1993 "Për një shtojcë në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", në nenin 2[1]. Prej vitit 1998, liria e shprehjes, shtypit, radios dhe televizionit si dhe e drejta për informim, janë garantuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.[2] Shqipëria ka aderuar në një sërë Konventash Ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, në kuadër të anëtarësimit të vendit tonë në Kombet e Bashkuara dhe Këshillin e Evropës. Ndër këto Konventa, neni 10 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbron lirinë e shprehjes dhe është zhvilluar dhe interpretuar në sajë të jurisprudencës së pasur të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ).

Nën perspektivën e kryesimit të OSBE-së nga Shqipëria gjatë vitit 2020, një grup organizatash të shoqërisë civile i rekomanduan qeverisë shqiptare të përmbushë frymën e angazhimeve të ndërmarra si anëtare e Këshillit të Europës dhe OSBE-së për të siguruar një mjedis të favorshëm për lirinë e shprehjes dhe medias, duke rritur përpjekjet për të zbardhur sulmet fizike ndaj tyre. Bazuar në nenin 17 të Kushtetutës që parashikon kriteret e domosdoshme në rastet kur mund të kufizohen të drejtat dhe liritë kushtetuese, nenin 22 të Kushtetutës dhe nenin 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që garantojnë lirinë e shprehjes, rekomandohet gjithashtu, tërheqja e qeverisë nga përpjekjet për të vendosur median nën kontroll të institucioneve publike, sikurse është Autoriteti i Medias Audiovizive që nuk ofron garancitë e mjaftueshme të pavarësisë dhe paanësisë.[3] Pavarësisht tregut të larmishëm mediatik që operon në vend, "Reporterët pa Kufij" e renditën Shqipërinë në vendin e 83-të ndër 180 vendet e vlerësuara në raportin e tyre "Indeksi i Lirisë Botërore të Shtypit" për vitin 2021, duke u lënë pas nga Kosova, që u rendit në vendin e 79-të.[4] Gjithashtu, "Freedom House", në raportin e saj mbi lirinë për vitin 2021, vlerëson se "ndërsa

---

[1] Ligj nr.7692, datë 31.03.1993. Për një shtojcë në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".- Fletorja Zyrtare 3, Mars 1993, f.161; Neni 2.

[2] https://www.parlament.al/Files/sKuvendi/kushtetuta.pdf

[3] Shih raportin "Vlerësimi i të Drejtave të Njeriut dhe Shtetit të së Drejtës teksa Shqipëria kryeson OSBE-në Janar, 2021" i aksesueshëm në: https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2021/01/Vleresimi-i-te-Drejtave-te-Njeriut-dhe-Shtetit-te-se-Drejtes-teksa-Shqiperia-kryeson-OSBE-ne.pdf

[4] https://rsf.org/en/ranking

Kushtetuta garanton lirinë e shprehjes, ndërthurja e interesave të fuqishme të biznesit, politike dhe mediatike pengon zhvillimin e mediave të pavarura".[5]

Në Dhjetor të vitit 2019, parlamenti miratoi dy ligje pjesë e paketës "antishpifje". Kjo paketë u kritikua që në fazat e hershme të hartimit të saj nga organizatat e shoqërisë civile dhe ato të medias, të cilat shprehën shqetësimin për kërcënim ndaj lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes[6]. Këshilli i Evropës kritikoi ligjin për parametrat e tij të paqartë dhe potencialin e tij për të penguar raportimin në internet.[7] Sipas vendimit të Këshillit të Bashkimit Europian, në mars të 2020-ës, për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut para konferencës së parë ndërqeveritare, qeveria shqiptare duhet të zbatonte një numër kushtesh, përfshirë "ndjekjen e rekomandimeve të Komisionit të Venecias për legjislacionin e diskutueshëm (kontrovers) kundër medias."[8]. "Paketa" ka mbetur e pamiratuar tërësisht, pas rekomandimeve të Komisionit të Venecias për modifikimin e saj.[9]

Vlen të theksohet gjithashtu se, "Freedom House" në raportin e vitit 2021, konstaton se "gazetarët kanë pak siguri në punë dhe vijojnë të paditen, kërcënohen apo sulmohen fizikisht në mënyrë të herë pas hershme nga ata që ndeshen me kontrollin e medias. Media e shkruar vijon të përballet me rënien e të ardhurave, çka ka ulur pagat e gazetarëve". [10]

Paralelisht me problemet e lirisë së medias, punonjësit e medias në Shqipëri vijojnë të përballen me një sërë problemesh me gëzimin dhe ushtrimin e të drejtave të punës. Një studim i realizuar nga Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore dhe Citizens Channel zbuloi se pjesa dërrmuese e reporterëve të rinj shfrytëzohen nga drejtuesit e mediave gjatë të mbiquajturave praktika pune, ndërkohë që edhe gazetarët me përvojë kanë probleme me marrëdhëniet kontraktuale në punë.[11] Gjithashtu, një raport studimor i publikuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në vitin 2020 rikonfirmoi mungesën e kontratave të punës, abuzimin me kohën e provës, problemet me pagat apo mosrespektimin e kushteve në punës së punonjësve në sektorin e medias.[12] Pavarësisht parashikimeve të Kodit të Punës që i mundëson një grupimi prej të paktën 20 punëmarrësish të organizohen në sindikatë, me qëllim përfaqësimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave ekonomikë, profesionalë dhe shoqërorë të anëtarëve të tyre, gazetarët apo më gjerë, punonjësit e medias në vendin tonë nuk janë të organizuar në lëvizje sindikale. Në raportin studimor të KShH-së për vitin 2020 (përmendur më sipër), vetë gazetarët raportojnë se një prej shkaqeve apo

---

[5] https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2021

[6] https://citizens-channel.com/2020/01/30/organizatat-nderkombetare-thirrje-qeverise-shqiptare-per-te-mos-votuar-paketen-anti-shpifje/

[7] https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/commissioner-urges-albania-s-parliament-to-revieë-bills-ëhich-restrict-freedom-of-expression

[8] Konkluzione të Këshillit mbi zgjerimin dhe stabilizimin dhe procesin e asociimit - Shqipëria dhe Republika e Maqedonisë së Veriut, Këshilli i Bashkimit Europian, 2020, https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/en/pdf

[9] https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2020)013-e

[10] https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2021

[11] https://issuu.com/citizenschannel/docs/duke_synuar_kushte_t__drejta_pune

[12] https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor_Te-drejta-pune-per-gazetaret_ALB-1.pdf

pengesave për krijimin e sindikatës është frika e tyre nga veprimet hakmarrëse të pronarëve të medias[13].

2. Përmbledhje ekzekutive

Të dhënat e Barometrit konfirmojnë gjendjen e përkeqësuar të lirisë së shprehjes gjatë vitit që lamë pas, të matur në raportet vjetore nga Freedom House dhe Reporterë pa Kufij. Përpjekjet për të imponuar paketën e ashtuquajtur anti-shpifje, lajmet e gatshme nga forcat politike dhe ngjarje konkrete si: protesta dhe prishja e teatrit kombëtar dhe pandemia përmenden veçanërisht në përgjigje si shenja të përkeqësimit të lirisë.

Analiza sasiore dhe cilësore e të dhënave të grumbulluara nga Barometri dëshmon një sërë problemesh që krijojnë një klimë tkurrëse për lirinë e medias në vendin tonë, si pasiguria në punë, mungesa e stabilitetit ekonomik në tregun e punës, mungesa e formalizimit të marrëdhënies së punës apo asaj të ofrimit të shërbimit nëpërmjet kontratave sipas kuadrit ligjor në fuqi, një mjedis të pasigurtë me kërcënime dhe ngacmime, censurë dhe autocensurë. Një pjesë e mirë e këtyre problematikave dhe faktorëve nuk është risi, por rezultojnë të mbartura ndër vite, e vijojnë të mbeten të pazgjidhura, edhe të risjella në vëmendje të vazhdueshme të autoriteteve publike përgjegjëse.

Barometri përcjell gjithashtu të dhëna mbi perceptimin e vetë punonjësve të medias mbi lirinë profesionale dhe shkaqet që ndikojnë në cënimin e lirisë së medias në vend. Të anketuarit referojnë se përfaqësues të qeverisjes qendrore dhe vendore si dhe partitë politike identifikohen qartazi si censorët dhe kufizuesit kryesorë të lirisë së medias, por gjithashtu edhe pronarë të mediave, përfaqësues të organeve ligjzbatuese dhe edhe persona të identifikuar si të implikuar në vepra të ndryshme penale apo "të fortët e zonës".

Gjetjet e Barometrit janë të ndara në tri seksione. Seksioni i parë sjell të dhëna konkrete mbi gjendjen dhe respektimin e të drejtave të gazetarëve në vendin e punës. Seksioni i dytë sjell të dhëna mbi situatën dhe faktorët që ndikojnë në lirinë profesionale të punonjësve të medias. Ndërkohë që, seksioni i tretë përmban të dhëna mbi faktorët që sipas punonjësve të sektorit ndikojnë në cenimin e lirisë së medias, si dhe sugjerimet e tyre mbi masat që do të ndihmonin më shumë rritjen e lirisë së medias.

- *Liria sindikale*

Një shumicë dërrmuese e punonjësve të medias mendojnë se rritja profesionale dhe sindikalizmi do të ndihmonin gazetarët dhe do të përmirësonin lirinë e medias dhe kushtet e punës. Punonjësit

[13] Citim nga raporti, shih fq. 73 – 74. Një rast konkret qe në vitet 2016-2017 në momentin që filluam të kishim probleme me rrogat, thërrasim pronarin dhe bëmë një kërkesë për informim. Ata e quajtën peticion, nënshkruam 15 vetë. Kërkonim të na deklarohet në bankë rroga e plotë, të na paguhet në kohë në datën e përcaktuar.... Kjo turbulloi gjithë redaksinë, erdhi pronari që nuk kishte ardhur deri në atë moment të shihte si punonim dhe e quajti kryengritje dhe tha «nuk lejoj sindikalizmin, nuk lejohen sindikatat në këtë punë» dhe si përfundim një gazetare iku nga puna, sepse ajo e dorëzoi kërkesën.

e medias pohojnë se duhet të kenë një sindikatë për të mbrojtur të drejtat e tyre në punë dhe kushte më të mira të punës. Konkretisht, 197 apo 98.5% e të anketuarve ishin pro ngritjes së saj.

- *Informaliteti në punë*

68.8% e të anketuarve pohuan se punojnë bazuar në një kontratë të rregullt pune, ndërsa pjesa tjetër prej 30.2% u përgjigjën se nuk kanë një kontratë të rregullt pune apo nuk kanë informacion për marrëdhënien e tyre kontraktuale.

- *Bullizimi*[14]*/tallja në vendin e punës*

11.5% e të anketuarve pohuan se ishin bullizuar/tallur gjatë punës apo për shkak të saj, në ambientin e punës. Në këtë kategori, shumica e tyre pohuan se kishin më shumë se 10 vite përvojë në punë dhe se sjelljet e bullizmit kishin ndodhur në vitet e para të karrierës.

- *E drejta për pushime javore dhe vjetore*

Kodi i Punës parashiokon të drejtën e punëmarrësve për pushime javore dhe vjetore, ku nga anketimi rezulton se:

- 59% e të anketuarve deklarojnë se punojnë 6 ditë në javë, ndërkohë që 18% e të anketuarve deklarojnë se nuk bëjnë asnjë ditë pushim.
- 63.5% e të pyeturve deklaruan se bëjnë 14 ose 15 ditë pushim në vit, ndërkohë që vetëm 16.5% e tyre gëzojnë efektivisht pushime të plota vjetore.

- *Kërcenimet për shkak të punës*

Të dhënat e Barometrit evidentojnë raste të shpeshta të kërcënimit fizik dhe verbal ndaj gazetarëve e punonjësve të medias, çka ndikojnë në prezencën e një klime vetë-censure ndaj medias në vendin tonë. Përkatësisht, 33 % e të pyeturve raportuan se ishin kërcënuar fizikisht për shkak të punës apo gjatë kryerjes së saj, ndërkohë që 51.5% raportojnë kërcënime verbale.

Të anketuarit tregojnë se janë sulmuar apo ndjerë të kërcënuar prej punonjësve të policisë, protestuesve, personave të dyshuar për lidhje me botën e krimit dhe nga subjekte të tjera (si psh personat e përfshirë në konfliktet që raportoheshin mediatikisht, pasi kanë tentuar tu marrin apo dëmtojnë mjetet e punës). Shqetësues në të gjitha rastet e mbetet fakti se autorët e dhunës nuk janë ndëshkuar.

- *Stresi dhe situata traumatike*

---

[14] "**Bullizmi**" është përdorimi i forcës, shtrëngimit, ngacmimeve ose kërcënimeve lënduese apo që shkaktojnë dhimbje, me synimin për të abuzuar, dominuar ose frikësuar në mënyrë agresive. Sjellja shpesh përsëritet dhe bëhet e zakonshme. Një parakusht thelbësor është perceptimi (nga ngacmuesi ose nga të tjerët) i një ç'ekuilibri të pushtetit fizik apo shoqëror. Ky ç'ekuilibër e dallon ngacmimin nga konflikti.
Burimi për referimin e këtij përkufizimi është marrë nga Juvonen, J.; Graham, S. (2014). "Bullying in Schools: The Power of Bullies and the Plight of Victims". Annual Review of Psychology. 65: 159–85.

Shqetësues është fakti se mbi 88 % e punonjësve të medias raportuan nivele të larta stresi për shkak të punës. Një pjesë e mirë e tyre, 79.5 % raportuan se kishin mbuluar dhe raportuar ngjarje, të cilat u kishin krijuar tronditje të fortë psikologjike. Por pavarësisht nga këto shifra, vetëm një pjesë e vogël, 10% pranuan se kishin kërkuar ndihmë mjekësore apo psikologjike.

- *Censurë dhe vetëcensurë*

Lidhur me rastet e censurës apo vetëcensurës të dhënat e raportuara tregojnë një klimë tkurrëse të lirisë së medias në vendin tonë.

Përkatësisht, 49.5% e të anketuarve pohuan se u ishte kërkuar direkt apo përmes redaktorit apo kryeredaktorit të mos publikonin një lajm. Këto raste sipas tyre lidhen me interesa të punëdhënësit sa i takon ndikimeve të rrethit shoqëror, biznesit dhe në raport me funksionarë publikë apo përfaqësues të institucioneve shtetërore. Në një nivel pak më të lartë paraqiten perceptimet për rastet e vetë-censurës, ku 52% e të anketuarve pohuan kishin shmangur raportimin e një lajmi, për shkak se kishin menduar se ai nuk do i pëlqente punëdhënësit. Shumica e të anketuarve që janë vetë-censuruar kanë mohuar se kjo lidhej me pasigurinë për vendin e punës apo zgjidhjes së kontratës nga punëdhënësi.

Vetë vlerësimi i lirisë së medias

Pjesa më e madhe e të anketuarve apo 66.5% e tyre perceptojnë se media në Shqipëri është pak ose aspak e lirë. Ndërkohë që 30.5% vlerësojnë se media është mesatarisht e lirë. Vetëm 3% e të anketuarve mendojnë se media në vend është e lirë apo plotësisht e lirë.

- *Faktorët ndikues*

Të anketuarve iu kërkua të përzgjidhnin deri në 3 alternativa për faktorët ndikues sa i takon cënimit të lirisë së medias në vendin tonë gjatë vitit 2020. Të dhënat evidentojnë se:

- 90% e të anketuarve perceptojnë se ndërhyrjet e qeverisë apo partive politike konsiderohen si faktori kryesor që cenon lirinë e medias,
- në masën 80% renditen interesat e bizneseve të drejtuara nga pronarët e mediave.
- Si alternativë të tretë, në 21.5% të rasteve, të anketuarit besojnë se ka ndikim edhe nga persona të përfshirë në krimin e organizuar.

- *Gazetaria cilësore*

Sipas 77% të të anketuarve, gazetaria cilësore shënon nivele të njëjta ose rënie gjatë 2020-ës, krahasuar me një vit më parë (2019). Faktorët ndikues sipas tyre janë të lidhura me:

- situatën e pandemisë dhe efektet e saj,
- përpjekjet për rregullimin e medias me paketën ligjore “anti-shpifje”, e cila krijonte premisa për censurë dhe vetë-censurë, si dhe
- shembja e Teatrit Kombëtar.

- *Pengesat për t’iu drejtuar gjykatës kur cënohet liria e shprehjes*

Të anketuarit listojnë një sërë arsyesh, që i pengojnë ata t'i drejtohen gjykatës nëse liria e tyre e shprehjes cenohet, si psh burokracitë dhe vonesat e procedurave gjyqësore (64%), frika nga hakmarrja e punëdhënësit (54.5%) si dhe frika se nuk do të punësohen nga punëdhënës së tjerë për shkak të solidaritetit që ekziston në të tilla raste midis pronarëve të medias (44%).

Pjesë e Barometrit janë edhe të dhënat e marra nga kërkesat për informacion që KShH i ka drejtuar gjykatave të rretheve gjyqësore lidhur me numrin e çështjeve gjyqësore në proces, të pushuara, të pezulluara me palë gazetar apo punonjës të medias. ***Nga 23 gjykata rrethesh, kanë kthyer përgjigje 17 prej tyre[15], prej të cilave 4 referojnë të kenë të regjistruara çështje gjyqësore apo të jenë dhënë vendime lidhur me gazetarë ose punonjës të medias[16].*** Referuar informacioneve të marra nga gjykata për periudhën Janar – Dhjetor 2020, rezultojnë të dhënat si vijojnë:

- Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë rezulton një çështje penale në shqyrtim, me objekt "Ndërhyrje të padrejta në jetën private", parashikuar në nenin 121 të Kodit Penal.
- Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fieri, janë regjistruar tre çështje[17] nga të cilat, një çështje është civile mbi detyrim pagese dhe kontributesh shoqërore të gazetarit dhe dy çështjet e tjera janë penale për kundërshtim të punonjësit të policisë.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë rezulton të ketë pasur një çështje penale të pushuar lidhur me veprën penale të "Fyerjes së gjyqtarit ose Prokurorit".
- Në Gjykatën e Gjirokastrës rezulton të jenë regjistruar dy çështje penale[18] me palë gazetar dhe punonjës medie, për veprën penale të "Shpifjes".

Nuk është aspak ndihmuese për vlerësimin e situatës së lirisë së shprehjes, qasja e disa Gjykatave të Rretheve Gjyqësore (Shkodër, Berat dhe Tiranë) të cilat referuan se mënyra e grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave, nuk identifikon profesionin e palës dhe rrjedhimisht, e kanë të mundur të evidentojnë çështjet me palë gazetarë apo punonjës të medias, nëse ata nuk identifikohen me gjeneralitetet e tyre nga kërkuesi i informacionit.

- *Faktorët që kontribuojnë në rritjen e lirisë së medias*

Të anketuarve iu kërkua të përzgjidhnin 3 alternativa mbi faktorët që kontribuojnë për garantimin e lirisë së medias në vendin tonë. Të dhënat e përpunuara reflektojnë se:

- Për 66% e të anketuarve nevojitet një përgatitje më e mirë profesionale e gazetarëve – (nëpërmjet trajnimeve, forcimit të integritetit profesional, etj);
- Për 63% e të anketuarve është e nevojshme të krijohet një sindikate që ti përfaqësojë dhe mbrojë denjësisht;
- Për 43% e të anketuarve, është e nevojshme të ketë pavarësi të pronarëve të medias nga politika.

---

[15] Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Kavajë, Mat, Berat, Shkodër, Pogradec, Dibër, Gjirokastër, Kurbin, Krujë, Fier, Tropojë, Pukë, Lezhë, Përmet, Korçë, Sarandë, Tiranë

[16] Gjykata e Kavajës, Matit, Pogradecit, Dibër, Kurbin, Tropojës, Pukës, Lezhë, Përmet dhe Sarandës kanë referuar se për periudhën Janar – Dhjetor 2020 nuk kane pasur çështje gjyqësore si edhe nuk janë dhënë vendime me palë përfaqësues të medias apo gazetarë.

[17] Për këto çështje gjykata ka marrë vendim në 2021.

[18] Në njëra prej tyre një gazetar ka marrë vendim pafajësie, ndërkohë çështja tjetër është ende në shqyrtim.

Nisur nga perceptimet e punonjësve të medias dhe shqetësimet që ata ndajnë për lirinë e medias në vendin tonë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka evidentuar në përfundim të Barometrit, me ndihmën e ekspertëve të angazhuar, disa rekomandime që mund ti shërbejnë përmirësimit të situatës në të ardhmen.

3. Metodologjia

Të dhënat e Barometrit, janë marrë duke përdorur metodën e sondazhit, i cili është realizuar me anë të një pyetësori elektronik të hartuar nga ekspertë të medias, dhe i rishikuar më pas nga KShH. Pas finalizimit të tij dhe metodologjisë se si do të realizohej ky sondazh, dy gazetarë kanë kontribuar për të kontaktuar në rrugë elektronike dhe telefonike, përkatësisht 350 punonjësve të medias (gazetarë, kryeredaktorë, redaktorë, regjisorë, operatorë, etj).

Pyetësori është ndarë më formatin *google drive*, i cili i ka mundësuar të interesuarve ta plotësojnë në mënyrë të pavarur dhe të pandikuar nga ekspertët që i kanë kontaktuar. Pyetësori i hartuar përbëhej nga 47 pyetje (të mbyllura dhe/ose të hapura). Pas plotësimit të pyetësorit dhe hedhjes në sistem, të dhënat për përgjigjet e pyetjeve që janë përzgjedhur sipas alternativave të propozuara (të mbyllura), janë përpunuar në formën statistikore. Të dhënat për përgjigjet e hapura, janë përpunuar nga pikëpamja cilësore nga ekspertët e angazhuar për zbatimin e Barometrit. Personave të pyetur, i është lënë mundësia ta plotësojnë në mënyrë anonime pyetësorin, me qëllim të ndiheshin të lirë dhe jo të paragjykuar për përgjigjet e dhëna.

Ofrimi i mundësisë së anonimatit u vlerësua nga ekspertët e medias se nxit një nivel më lartë të reagimit pozitiv për t'ju përgjigjur Barometrit. Si rezultat, interesit për Barometrin i janë përgjigjur 200 punonjës të sektorit të medias. Vlen të theksohet se, kampioni i përzgjedhur, pavarësisht se është i konsiderueshëm nuk mund të krahasohet objektivisht me numrin total të punonjësve të sektorit të medias në vendin tonë. Kjo për arsye se mungojnë të dhëna të sakta lidhur me këtë tregues. Referuar botimeve të organizatave të shoqërisë civile apo ekspertëve të fushës, evidentohet se në vitin 2019, kemi rënien e numrit të punonjësve të medias, nga 6200 në 5900 vetë. Arsyeja kryesore lidhet me mbylljen e disa mediave, dixhitalizimin por edhe me largimet e gazetarëve nga profesioni për shkak të pakënaqësive me kushtet e punës[19].

Metodologjia e kampionimit synoi që shpërndarja e tij të ishte përfaqësuese, duke marrë në konsideratë elementë si gjinia dhe shpërndarja gjeografike, përkatësisht në qytetet e Tiranës, Gjirokastrës, Vlorës, Fierit, Shkodrës, Elbasanit, Durrësit, Pogradecit, Lezhës, Kukësit, Kavajës, Librazhdit dhe Lushnjes. Për shkak të natyrës së pyetjeve, sondazhit i janë përgjigjur një numër shumë i lartë gazetarësh (rreth 80%), ndërkohë që i janë përgjigjur në minorancë, punonjës të tjerë të sektorit të medias (Regjisor, montazhier, kameramanë, teknikë transmetimi, etj). Për sa i takon mediave ku janë të punësuar, të parët më të përfaqësuar në të dhënat që Barometri janë punonjësit e televizioneve. Ndryshe nga pyetësorë të mëparshëm të kësaj natyre, për shkak se numri i gazetave dhe revistave ka rënë ndjeshëm, të dytët më të përfaqësuar sa i takon të dhënave të Barometrit janë punonjësit e portaleve online.

Sondazhi u realizua gjatë periudhës 1 – 20 Korrik 2021, por të dhënat e tij i referohen periudhës Janar – Dhjetor 2020. Pyetjet janë organizuar në 3 blloqe të ndryshme.

- ***Blloku i parë i pyetjeve*** mundëson mbledhjen e të dhënave konkrete mbi gjendjen dhe respektimin e të drejtave të gazetarëve në vendin e punës. Më konkretisht ai paraqet të

[19] Open Society Foundation, Peizazh i medias online në Shqipëri. Tiranë: OSFA, 2018
Kabashi, Gëzim. "Kosotot e dixhitalizimit mbyllin televizionet lokale". BIRN, Nëntor 9, 2019

dhëna mbi marrëdhënien kontraktuale në punë, kohëzgjatjen e kontratës, pushimet javore dhe ato vjetore, si dhe mbi nevojën për ngritjen e një sindikate për të mbrojtur të drejtat e tyre në punë.

- ***Blloku i dytë i pyetjeve*** mundëson mbledhjen e të dhënave mbi situatën dhe faktorët që ndikojnë në lirinë profesionale të punonjësve të medias. Këtu përfshihen kërcënimet gjatë ushtrimit të profesionit, stresi apo tronditjet psikologjike si pasojë e punës apo ndikimi që kanë punëdhënësit/redaktorët në transmetimin e ngjarjeve.

- ***Blloku i tretë i pyetjeve*** përmban pyetje për të dhëna mbi faktorët që sipas punonjësve të sektorit ndikojnë në cenimin e lirisë së medias, si dhe sugjerimet e tyre mbi masat që do të ndihmonin më shumë rritjen e lirisë së medias.

Barometri pasqyron gjithashtu të dhënat e përftuara me kërkesa për informacion drejtuar disa gjykatave në vend, sa i takon numrit të çështjeve gjyqësore (civile apo penale) me palë ndërgjygjëse ose të pandehur gazetar dhe punonjës të sektorit të medias dhe vendimmarrjes për to, nëse ka patur, për periudhën Janar – Dhjetor 2020.

❖ **Të dhëna të përgjithshme për të anketuarit**

Të dhënat e kategorizuara për personat që i janë përgjigjur Barometrit, pasqyrohen në vijimësi:

a) Gjinia

113 e të anketuarve apo 56.5% e tyre ishin femra, ndërsa 87 apo 43.5% e totalit ishin meshkuj.



b) Mosha

Të dhënat e kategorizuara sipas moshës së të anketuarve evidentojnë se:

- 23% e tyre i përkisnin grupmoshës 20-30 vjeç,
- 49.5% bënin pjesë në grupmoshën 30-40 vjeç,
- 23% i përkisnin grupmoshës 40-50 vjeç.
- në grupmoshën 50-60 vjeç bënin pjesë 4% e të anketuarve,
- ndërsa 0.5% ishin mbi 60 vjeç.



c) *Përvoja në sektorin e medias*

Shumica e të anketuarve rezultojnë me përvojë në sektorin e medias. 61% e atyre që i përgjigjur Barometrit, referojnë se kanë mbi 10 vjet që ushtrojnë profesionin. Konkretisht disa prej të dhënave lidhur me përvojën rezultojnë si vijon:

- Më shumë se 1/3 e tyre ose afro 37.5% referojnë se kishin mbi 15 vjet përvojë.
- 27.5 e të anketuarve kishin 10-15 vjet përvojë
- 13% e të anketuarve kishin 5-10 vjet përvojë,
- 18% kanë 1-5 vjet përvojë,
- ndërkohë që 4% e totalit kishin më pak se një vit që punonojnë në sektorin e medias.

Fig.3 Ndarja e të anketuarve sipas viteve të eksperiencës në punë



d) *Pozicioni*

Në sondazh u përfshinë punonjës të medias që ushtrojnë profesionin në pozicione të ndryshme. Rreth 64% e tyre u vetëdeklaruan gazetarë, 8.5% kryeredaktorë dhe 6.5% redaktorë. Pjesa tjetër, prej rreth 20% përfshinin punonjës në pozicione të tjera, si: Regjisor, montazhier, kameramanë, teknikë transmetimi, etj.

Fig.4 Ndarja e të anketuarve sipas pozicionit në punë



e) *Shpërndarja gjeografike*

74 % e të anketuarve deklaruan se punojnë në kryeqytet, ndërsa 26% e tyre referuan se punonin në qytete të tjera të vendit.

Fig.5 Ndarja e të anketuarve sipas shtrirjes gjeografike të medias



f) Kategorizimi i medias

Barometri u shtri në të gjithë territorin e vendin, duke përfshirë punonjës të mediave lokale,

Fig. 6 Ndarja e të anketuarve sipas medias ku janë të punësuar/angazhuar (Lokale/Kombëtare)



kombëtare, rajonale dhe atyre ndërkombëtare. Kjo ndarje nuk reflekton automatikisht vendndodhjen gjeografike të të anketuarve, pasi ata që ushtrojnë profesionin në rrethe janë korrespondentë të mediave kombëtare.
Rreth 74.5 % e të anketuarve deklaruan se ishin të atashuar/punësuar në mediat kombëtare.

Pjesa më e madhe e të anketuarve apo 72% e tyre, në momentin e intervistimit ushtronin profesionin e tyre në një prej televizioneve në vend. 11.5% u deklaruan se punonin në portale online me qëllim informimin. Ndërkohë, 9% e të anketuarve punonin në median e shkruar, nga të cilët 8.5% në gazetë dhe vetëm 0.5% në revistë. Gjithashtu, 6% e pjesëmarrësve në sondazh ishin të vetëpunësuar (freelance), ndërsa 1.5% u deklaruan se punonin në organizata të shoqërisë civile.

Fig.7 Ndarja e të anketuarve sipas llojit të medias



4. Respektimi i të drejtave të gazetarëve në vendin e punës

4.1. Informaliteti në punë

Me qëllim ofrimin e një panorame sa më të qartë mbi respektimin e të drejtave të punonjësve të medias në punë, fillimisht të anketuarit u pyetën mbi marrëdhënien kontraktuale me punëdhënësin e tyre.



68.8% e të anketuarve pohuan se punojnë bazuar në një kontratë të rregullt pune, ndërsa pjesa tjetër prej 30.2% u përgjigjën se nuk kanë një kontratë të rregullt pune apo nuk kanë informacion për marrëdhënien e tyre kontraktuale.

Sa i takon kohëzgjatjes së kontratës, vetëm 41.5% e të anketuarve u përgjigjën se kanë një kontratë pune pa afat. 26.5% e të anketuarve u përgjigjën se kanë kontratë me afat 1-vjeçar, ndërkohë që 16.5% deklaruan se nuk disponojnë fare një dokument të tillë.



Këto të dhëna tregojnë se në sektorin e medias vijojnë në përqindje të konsiderueshme, praktikat e informalitetit të punonjësve të padeklaruar. Shqetësues është fakti se mbi 31% e të anketuarve



deklarojnë se nuk e marrin të plotë pagën në bankë, çka është në shkelje të nenit 118 të Kodit të Punës.

Mosdeklarimi i plotë i pagës, që pasohet me shmangie të detyrimeve tatimore si dhe pagesave të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, përveç se përbën shkelje flagrante të legjislacionit në fuqi[20], gjithashtu shkakton pasoja negative në drejtim të përfitimeve direkte afatshkurtra dhe afatgjata për punonjësit e medias, duke cënuar kështu edhe të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, e cila mbrohet nga neni 8 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Ndër efektet e menjëherëshme është reduktimi i të ardhurave për paaftësi nga sëmundjet apo të ardhurat për barrëlindje, duke qenë se këto pagesa bëhen mbi bazën e pagës së deklaruar të punonjësit.[21] Gjithashtu, mungesa e deklarimit të pagës reale pranë organeve tatimore lidhet drejtpërdrejt me pensionin e pleqërisë.[22]

4.2. E drejta për pushime javore dhe vjetore

Anketimi nxjerr në pah se shumica e punonjësve të medias punojnë mbi normën e përcaktuar përgjatë një jave nga Kodi i Punës. Akoma më shqetësues është fakti i mungesës së pushimeve të mjaftueshme gjatë një jave kalendarike. Konkretisht, 59% e të anketuarve deklarojnë se punojnë 6 ditë në javë, ndërkohë që 18% e të anketuarve deklarojnë se nuk bëjnë asnjë ditë pushim. Puna, 7 ditë në javë është pohuar më së shumti nga punonjës që kanë 10-15 vjet përvojë në punë, që tregon se shkeljet të të drejtave të përcaktuara në Kodin e Punës nuk është një fenomen që shoqëron

Fig.11 Numri i ditëve pushim përgjatë 1 jave

punonjësit e rinj. Vetëm 13% e të anketuarve deklaruan se punojnë 5 ditë në javë, ndërkohë që 9% e tyre deklarojnë se punojnë sipas rastit, ku bëjnë pjesë ata punonjës që ushtrojnë profesionin pranë organizatave të shoqërisë civile, të cilat realizojnë materiale që i komunikohen medias apo publikut.

[20] Ligji Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në RSH", të ndryshuar dhe neni 117 i Kodit të Punës
[21] Neni nr. 26; 27; 28; 29, i ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;
[22] Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Anketimi nxjerr në pah se punonjësve të medias iu shkelen rëndom të drejtat në drejtim të pushimeve vjetore. Sipas "Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë" "kohëzgjatja e pushimeve vjetore është jo më pak se 4 javë kalendarike gjatë vitit të punës në vazhdim".[23] Por, 75% e punonjësve deklaruan se bëjnë më pak pushime vjetore se sa përcakton Kodi i Punës. 63.5% e të pyeturve deklaruan se bëjnë 14 ose 15 ditë pushim në vit, ndërkohë që vetëm 16.5% e tyre gëzojnë efektivisht pushime të plota vjetore.

Fig.12 Numri i ditëve pushim përgjatë 1 viti



4.3. Bullizmi/tallja në vendin e punës

11.5% e të anketuarve pohuan se ishin bullizuar/tallur gjatë punës apo për shkak të saj, në ambientin e punës. Në këtë kategori, shumica e tyre pohuan se kishin më shumë se 10 vite përvojë në punë dhe se sjelljet e bullizmit kishin ndodhur në vitet e para të karrierës, por që kishin lënë gjurmë. Një prej të anketuarve, punonjëse në televizion (e grupmoshës 40 deri në *50 vjeç)*, referoi se "*Jam tallur në vitet e para të punës, kur edhe mund të mos ia kesh dalë me raportimin live... kolegët më të vjetër e kthejnë në tallje ndonjë batutë që është përdorur pa vend*".

Sipas të anketuarve që kanë referuar sjellje të bullizmit, ato kryhen nga pronarët apo eprorët e punonjësve të medias dhe në disa raste nga kolegët më të vjetër. "*Ngacmimet janë kryesisht për pamjen fizike, për mënyrën si i mbaj flokët, etj*", shkroi një prej të anketuarave. Po ashtu, disa prej të anketuarve janë përgjigjur se janë tallur në ambientet e punës për shkak të origjinës, duke u etiketuar si provincialë apo edhe për shkak të pamjes së jashtme. Në një rast, një prej punonjësve të medias ka deklaruar se: "*Jam ndjerë i bullizuar nga persona të lidhur me pushtetin*".

[23] Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar

Fig.13 Prezenca e fenomenit të talljes te punonjësit e medias



4.4. Ngacmimet seksuale në vendin e punës

15 nga të anketuarit apo 7.5% e totalit deklaruan se ishin ngacmuar seksualisht në vendin e punës. Vetëm në një rast, një prej të anketuarve referoi se kishte qenë prezent gjatë sjelljeve të ngacmimit që u ndodhte personave të tjerë në një redaksi. Të gjithë të anketuarit që pohuan ngacmime seksuale ishin femra.

Fig.14 Prezenca e ngacmimit seksual te punonjësit e medias



Në pyetjet pasuese, gazetaret e ngacmuara seksualisht referojnë se janë ulur në detyrë për shkak se kanë bërë rezistencë apo kundërshtuar këto sjellje. Një prej të anketuarave referon si forma të ngacmimit seksual "*Kërkesë për të dalë, interesim për të patur marrëdhënie. Ulje profesionale për shkak të ngacmimit të refuzuar*". Përtej ngacmimeve me fjalë apo ofertave të ngjashme jo të përshtatshme, një prej gazetareve referon se ishte sulmuar fizikisht dhe se për shkak të traumës së pësuar, kishte kërkuar ndihmë mjekësore. Ajo referon se "*Ngacmime verbale që kanë shkuar deri tek tentativa për të më prekur në vende intime. Kur personat janë refuzuar unë jam ndëshkuar me eleminim nga lajmi i ditës (puna e ditës) dhe shfaqja në ekran*".

4.5. Nevoja për krijimin e Sindikatës së Punonjësve të Medias

Sipas nenit 176, paragrafi 1 të Kodit të Punës të RSH-së , "Organizatat sindikale dhe organizatat e punëdhënësve janë organizata shoqërore të pavarura, që krijohen si bashkime vullnetare të

punëmarrësve ose punëdhënësve, qëllimi i të cilave është përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave ekonomikë, profesionalë dhe shoqërorë të anëtarëve të tyre". Në dispozitat vijuese parashikohet ndër të tjerash, mënyra e krijimit të organizatave sindikale, elementët që duhet të mbajë statuti i tyre, kufirin minimal të anëtarëve themelues të tyre (përkatësisht jo më pak se 20 anëtarë për sindikatat), fitimin e personalitetit juridik pasi organizata të ketë depozituar aktin e themelimit dhe statutin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, parimet që udhëheqin këto organizata, ku ndër më të rëndësishmit është se zgjidhja e kontratës së punës, nga punëdhënësi, për përfaqësuesit e organizatës sindikale, pa pëlqimin e kësaj organizate, është e pavlefshme, etj.

Pothuajse unanimisht, punonjësit e medias pohojnë nevojën për krijimin e një sindikate për të mbrojtur efektivisht të drejtat e tyre në punë. Konkretisht, 197 apo 98.5% e të anketuarve ishin pro ngritjes së saj. Gjithashtu, në 85% të rasteve, të anketuarit pohuan se do të ishin pjesë aktive e sindikatës, ndërkohë 12.5% e tyre nuk e dinin nëse do të ishin pjesë e saj.





Fig. 15 dhe 16
Nevoja për organizimin në lëvizje sindikaliste dhe aktivizimi në një të tillë

Kërkesa në një masë kaq të madhe për ngritjen e një sindikate për punonjësit e medias duket se reflekton problemet disa vjeçare të lidhura me kushtet e këqija dhe mosrespektimin e legjislacionit në marrëdhëniet e punës ndaj tyre dhe nevojën për adresimin dhe zgjidhjen e tyre. Pavarësisht nismave të ndërmarra nga shoqatat e medias, ato nuk vlerësohen në parametrat e një sindikate, sa kohë, format e ndryshme të shkeljeve të të drejtave në marrëdhëniet e punës vijojnë të jenë në nivele shqetësuese.

.

5. Liria profesionale

5.1 Kërcënimet për shkak të punës

Të dhënat e Barometrit evidentojnë raste të shpeshta të kërcënimit fizik dhe verbal ndaj gazetarëve e punonjësve të medias, çka ndikojnë në prezencën e një klime censure ndaj medias në vendin tonë. Edhe pse vetëm një masë e vogël e ngjarjeve raportohen dhe pak prej tyre marrin vëmendje mediatike, në pyetësorë të anketuarit tregojnë se janë sulmuar apo ndjerë të kërcënuar prej punonjësve të policisë, protestuesve, personave të dyshuar për lidhje me botën e krimit apo të dënuar dhe të ngjashme (si psh personat e përfshirë në konfliktet që ata raportonin kanë tentuar tu marrin apo dëmtojnë mjetet e punës).

Gjatë vitit që shkoi në media janë raportuar raste kur policia ka shoqëruar disa orë gazetarë që ishin në krye të detyrës[24]. Kjo konfirmohet edhe nga katër prej të anketuarve, të cilët referojnë se janë kërcënuar apo ndjerë të kërcënuar prej policisë.

Fig.17 Kërcënimet fizike për shkak të punës

Të dhënat statisiktore të Barometrit reflektojnë se, 33 % e të anketuarve pohojnë se ishin kërcënuar fizikisht për shkak të punës apo gjatë kryerjes së saj. Një prej të anketuarve shkroi se shtëpia e tij ishte sulmuar me tritol dhe të tjerë përshkruan raste të kërcënimeve nga persona të armatosur apo në konflikt me ligjin, para publikimit të një lajmi. Shqetësues në të gjitha rastet e mbetet fakti se autorët e dhunës nuk janë ndëshkuar. Policia në disa raste ka njoftuar hetime të brendshme[25], por në asnjë prej rasteve nuk ka raporte që tregojnë se ndaj punonjësve të saj ishin marrë masa.

51.5% e të anketuarve pohuan se ishin kërcënuar verbalisht. Format me të cilat është kryer kërcënimi verbal, referohen të jenë me mesazhe telefonike, përmes mesazheve në rrjetet sociale apo edhe ballë për ballë. Një pjesë e tyre identifikuan se kërcënimet ishin bërë nga përfaqësues apo punonjës të institucioneve shtetërore. Një gazetare referoi me anë të pyetësorit se ndaj saj ishte bërë presion për ditë më radhë, se ishin shkruajtur artikuj dizinformues në media të tjera, duke e cenuar në dinjitet si dhe kishte patur telefonata që e mbanin nën presion. "*Një media elektonike shkroi për mua se isha e lidhur me zyrtarë të lartë. Jam marrë në telefon nga personat qe trilluan shkrimin dhe jam kërcënuar për ditë të tëra*", raportoi gazetarja.

[24] https://www.reporter.al/policia-perballet-me-kritika-ne-rritje-per-shoqerimin-e-gazetareve/
[25] https://www.reporter.al/ndalimi-i-gazetarit-elvis-hila-nga-policia-shcba-nis-hetimet/

Fig.18 Kërcënimet verbale për shkak të punës

A jeni ndjerë ndonjëherë i kërcënuar verbalisht si pasojë e punës tuaj?



Të pyetur nëse kishin gjetur mbështetje nga punëdhënësit në raste të kërcënimeve, 46 % e të anketuarve referojnë se kanë pasur mbështetje, 26.5% referojnë se nuk kanë patur mbështetje dhe 27.5% kanë plotësuar alternativën "Nuk e di".

5.2. Stresi dhe situatat traumatike

Mbi 88 % e punonjësve të medias raportuan nivele të larta stresi për shkak të punës. Një pjesë e mirë e tyre, 79.5 % raportuan se kishin mbuluar dhe raportuar ngjarje, të cilat u kishin krijuar tronditje të fortë psikologjike. Por vetëm një pjesë e vogël, 10% pranuan se kishin kërkuar ndihmë mjekësore për këto shkaqe. Ndër ata që kishin kërkuar ndihmë, shumica thonë se u janë drejtuar psikologëve dhe në disa raste mjekëve të familjes apo mjekëve psikiatër.

Fig.19 Përjetimi i stresit për shkak të punës.

A keni përjetuar ndonjëherë nivel të lartë stresi si pasojë e punës?



5.3. Censurë dhe vetëcensurë

49.5% e të anketuarve pohuan se ishin censuruar, pasi u ishte kërkuar direkt nga pronari apo përmes redaktorit apo kryeredaktorit, të mos publikonin një lajm. Në këtë kategori, 40% e të anketuarve specifikuan rastet kur kjo kishte ndodhur, kryesisht për ngjarje apo çështje që kanë qenë në vëmendje publike së fundmi. Ndër rastet e përmendura si censurë janë raportime për koncensionet për ndërtimin e inceneratorëve për menaxhimin e mbetjeve, interesa që preknin rrethin shoqëror apo të lidhura me biznesin në raport me punëdhënësin, protestës dhe çështjes së lidhur me prishjen e Teatrit Kombëtar, etj.



Fig.20 Mbi kërkesën për të mos publikuar një lajm

"*Nuk jam lejuar të publikoj lajme kritike ndaj Bashkisë Tiranë, hera e fundit ishte kur bëra kronikë për një protestë të një grupi qytetarësh pasi u hoqën abonetë e përgjithshme, shefi im ma censuroi lajmin duke më thënë se kisha shkuar me kokën time në protestë edhe pse më kishte dërguar atje redaksia*", shprehet një prej të anketuarve.

Një tjetër i anketuar thotë se: *"Për më shumë se 15 vite punë rastet janë shumë. Po përmend më të fundit: Zërat kundër, pas shembjes se godinës së Teatrit Kombëtar*". Ndër të pyeturit, ka edhe prej atyre që bëjnë të qartë se kishin frikë se do të penalizoheshin nëse do të tregonin raste të censurës.

Lidhur me sa më sipër 33.5% pranuan se u ishte dashur të linin në mes një hulumtim apo punën për realizimin e një lajmi. Shqetësues është fakti se 8% e të pyeturve pranojnë se u ishte kërkuar të publikonin lajme të rreme, ndërkohë që 7.5 % e të pyeturve nuk ishin të sigurt nëse kjo kishte ndodhur.

Fig.21 Kërkesat për të publikuar lajme të rreme

Vetëcensura, edhe pse me ndryshim të vogël nga censura është më e pranishme sipas përgjigjeve të të anketuarve. 52% thanë se ata kishin shmangur raportimin e një lajmi për shkak se kishin menduar se ai nuk do i pëlqente punëdhënësit, 42% thanë se kjo nuk kishte ndodhur dhe 6% nuk ishin të sigurt për përgjigjen. Një raport i BIRN në vitin 2017[26] mbi këtë temë vë në dukje se gazetarët përpiqen të fshehin rastet e vetëcensurës kur pyetja është direkt për ta dhe punën e tyre,

[26] https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2017/05/Raport-mbi-vetecensuren-ne-median-shqiptare.pdf

ndërsa kanë një perceptim se ajo ndodh më shumë në raport me të tretët, duke patur parasysh kolegët apo media të tjera nga vendi i tyre i punës.

Fig.22 Të dhënat për vetëcensurë

Është kontradiktor fakti se, edhe pse kanë thënë se vetëcensuroheshin, shumica e të anketuarve kanë mohuar se kjo lidhej me pasigurinë për vendin e punës apo frikën prej shkarkimit.

51.5% mohuan se publikimi i një lajmi mund të sillte shkarkimin nga puna, 30.5 % pohuan se e kishin këtë frikë, ndërsa 18 % ishin të pasigurtë.

Fig.23 Frika e pushimit nga puna për shkak të raportimeve

6. Vlerësimi i lirisë së medias

Të anketuarit u pyetën në një seksion të veçantë mbi perceptimin e tyre sa i përket lirisë së medias në vend në vitin që kaloi dhe sesi ka ndryshuar kjo situatë në raport me vitet e mëparshëm.
Ashtu siç del në raportet e Reporterëve Pa Kufij, liria e medias në Shqipëri, pas një përmirësimi relativisht të mirë deri në vitin 2018, u përkeqësua menjëherë në dy vitet e fundit, kur vendi ra nga i 75-ti në botë në të 84-in, një nivel i ngjashëm me atë të vitit 2014[27].

Përgjigjet e marra në këtë seksion evidentojnë faktorët, që sipas punonjëve të medias ndikuan në vitin 2020 më shumë në këtë drejtim. Pandemia. ligji i ashtuquajtur antishpifje dhe shembja e Teatrit Kombëtar u veçuan ndër ngjarjet që ndikuan më shumë në përkeqësimin e situatës.

Në këtë seksion të pyeturit kanë dhënë edhe sugjerimet tyre mbi mënyrat se si mund të ndryshohet kjo situatë, në të cilat kryesisht i është mëshuar arsimimit më të mirë të gazetarëve.

6.1. Perceptimi mbi lirinë e medias dhe tendenca me vitet e kaluara

Pjesa më e madhe e të anketuarve apo 66.5% e tyre mendojnë se media në Shqipëri është pak ose aspak e lirë. Ndërkohë që 30.5% thanë se media është mesatarisht e lirë. Vetëm 6 të intevistuar apo 3% e të anketuarve mendojnë se media në vend është e lirë apo plotësisht e lirë.

Fig.24 Perceptimi mbi nivelin e lirisë së medias



Ajo që mund të konsiderohet si një e dhënë shqetësuese është fakti se gati gjysma e të anketuarve mendojnë se liria e medias në Shqipëri është përkeqësuar në raport me një vit më parë. Ndërkohë që 45% e të anketuarve thanë se nuk ka ndryshim, në krahasim me vitin 2019. Duke mbajtur parasysh edhe përgjigjet e pyetjes së mësipërme, kjo nënkupton se edhe në vitin 2019 liria e medias në perceptimin e punonjësve të medias, në masën më të madhe ishte pak apo aspak e lirë.

[27] https://rsf.org/en/albania



6.2. Ngjarjet (faktorët) ndikues

Rreth 90% e të anketuarve pohuan se ndërhyrjet e qeverisë apo partive politike konsiderohen si faktori kryesor që cenon lirinë e medias, ndërsa pas tyre, në masën 80% renditen interesat e bizneseve të drejtuara nga pronarët e mediave. Të anketuarve iu kërkua të zgjidhnin deri në 3 alternativa për faktorët ndikues në cenimin e lirisë së medias, duke lënë mundësinë e shtimit të faktorëve të rinj. 31.5% e të pyeturve zgjodhën si alternativë të tretë përdorimin e medias për t'u pasuruar, 34.5% zgjodhën si alternativë të tretë bizneset që reklamohen në media dhe 21.5% besojnë se ka ndikim edhe nga krimi i organizuar.



Fig.26 Faktorët që cenojnë lirinë e medias

Punonjësit e medias listuan edhe një sërë ngjarjesh, që sipas tyre cenuan lirinë e medias përgjatë vitit 2020, përkatësisht të lidhura me përpjekjet e qeverisë për të rregulluar median me anë të paketës ligjore anti-shpifje, regjistrimet auido-vizive të gatshme që i vendoseshin medias në dispozicion nga partitë politike dhe ngjarje konkrete si: protesta dhe prishja e teatrit kombëtar dhe situata e pandemisë.

6.3 Gazetaria Cilësore

Edhe gazetaria cilësore, si një faktor i rëndësishëm që kontribuon pozitivisht në drejtim të lirisë së medias, shënon rënie ose nivele të njëjta si një vit më parë, sipas shumicës së të anketuarve. Në 38% të rasteve, ata pohojnë se gjatë vitit 2020, gazetaria cilësore ka qenë më pak prezente në media, 39% e tyre referuan se nuk ka ndryshuar, ndërkaq 23% deklaruan se gazetaria cilësore ka qenë më prezente.

Fig.27 Perceptimi mbi praninë e gazetarisë profesionale në media

6.4 Aksesi në Gjykatë

Të anketuarit renditin një sërë arsyesh, që i pengojnë ata t'i trejtohen gjykatës nëse liria e tyre e shprehjes cenohet. Burokracië në përballjen me gjykatën janë faktori kryesor (64% të rasteve), ndërsa pas tij vjen frika nga hakmarrja e punëdhënësit (54.5%). Arsyeja e tretë që ndikon në këtë drejtim është frika se nuk do të punësohet nga punëdhënës së tjerë për shkak të solidaritetit që ekziston në të tilla raste midis pronarëve të medias (44%).

Fig.28 Arsyet që pengojnë gazetarët t'i drejtohen gjykatës nëse cenohet liria e shprehjes



Njëkohësisht me realizimin e anketimit, është kërkuar informacion në vazhdimësi nga gjykatat e rretheve gjyqësore mbi të dhëna lidhur me numrin e çështjeve gjyqësore në proces, të pushuara, të pezulluara me palë gazetar apo punonjës të medias, si edhe natyrën e këtyre çështjeve, civile dhe penale, lidhur gjithashtu me veprat penale të Shpifjes dhe Fyerjes, si edhe sa prej tyre janë pushuar, sa janë pezulluar dhe për sa ajnë dhënë vendime pafajësie/fajësie, si edhe numrin e vendimeve të

marra me palë gazetar apo punonjës të medias, si edhe natyrën e këtyre çështjeve, civile dhe penale dhe kopje të anonimizuara të këtyre vendimeve.

Nga 23 gjykata rrethesh, kanë kthyer përgjigje 18 prej tyre, nga të cilat, 10 prej tyre kanë referuar se për periudhën Janar – Dhjetor 2020 nuk kanë pasur çështje gjyqësore si edhe nuk janë dhënë vendime me palë përfaqësues të medias apo gazetarë.

i) Në ***Gjykatën e Korçës*** rezulton një çështje penale me objekt "Ndërhyrje të padrejta në jetën private" Neni 121 i Kodit Penal.
ii) Në ***Gjykatën e Fierit***, janë regjistruar 3 çështje gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020 të cilat kanë marrë vendim në 2021. Një çështje është civile mbi detyrim pagese dhe kontributesh shoqërore të gazetarit, dy rastet e tjera janë penale për kundërshtim të punonjësit të policisë.
iii) ***Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë*** rezulton të ketë pasur në këtë periudhë 1 çështje penale të pushuar lidhur me veprën penale të "Fyerjes së gjyqtarit ose Prokurorit".
iv) Për periudhën Janar – Dhjetor 2020, në ***Gjykatën e Gjirokastrës*** rezulton të jenë regjistruar 2 çështje penale me palë gazetar dhe punonjës medie. Dy çështje gjyqësore janë regjistruar për veprën penale të "Shpifjes", njëra prej të cilave një gazetar ka marrë vendim pafajësie, ndërkohë çështja tjetër është ende në shqyrtim.

Ndërkohë Gjykata e Shkodrës, Gjykata e Beratit dhe Gjykata e Tiranës kanë referuar se në bazë të formës së tyre të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave në këto tre gjykata, nuk kryhet një cilësim i profesionit të palës dhe nuk e kanë të mundur të evidentojnë çështjet me palë gazetarë apo punonjës të medias.

7. Rekomandime

Të anketuarve iu kërkua të përzgjidhnin 3 alternativa mbi faktorët që kontribuojnë më shumë në rritjen e lirisë së medias dhe rrjedhimisht garantimit në nivele me të mira të saj.

a) Përgatitja më e mirë profesionale e gazetarëve është faktori i rekomanduar më së shumti, nga 66% e të anketuarve

b) Krijimi i një sindikate në mbrojtje të tyre, është faktori i renditur i dyti si më i rekomanduar nga 63% e të anketuarve.
Dy faktorët e mësipërm duket se kanë një lidhje të fortë me të drejtat e gazetarëve në punë dhe tregojnë siguri më të madhe në vendin e punës.

c) Pavarësia e pronarëve të medias nga politika renditet si faktori i tretë më i rëndësishëm, i rekomanduar nga 43% e të anektuarve.

Fig.29 Faktorët që do të ndihmonin rritjen e lirisë së medias



Të anketuarit përmendin në masë të gjerë nevojën e përmirësimit të kushteve të punës, përfshirë shpërblimin financiar dhe ngritjen e një sindikate për të mbrojtur të drejtat e tyre si kushte thelbësore për përmirësimin e respektimit të lirisë së shprehjes në vend. Praktikisht, pasiguria e gazetarëve për vendin e punës renditet prej vitesh nga Freedom House si një prej faktorëve që cënojnë lirinë e shprehjes. "Reporterët kanë pak siguri në punë dhe janë subjekte të padive, kërcënimeve dhe sulmeve fizike", thuhet në raportin për vitin 2020[28].

Gjithashtu, rritja e donacioneve të huaja konsiderohet nga të anketuarit një masë e rëndësishme, që do të sillte pavarësinë nga politika. Rritja profesionale përmes trajnimeve dhe integriteti profesional, janë të tjera masa që sipas të anketuarve do të ndikonin në këtë drejtim. Këto përgjigje janë dhënë në masë të madhe edhe kur të anketuarit u pyetën për veprimet që mund të ndërmerren me qëllim rritjen e cilësisë së shkrimeve/kronikave në medias shqiptare.

[28] https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2020

Me synim konkretizimin e rekomandimeve të adresuara nga vetë punonjësit e medias si dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e adresuara më herët në raportin studimor për të drejtat e gazetarëve në punë (publikuar në Maj të vitit 2020)[29], Komiteti Shqiptar i Helsinkit sugjeron si vijon:

Rekomandime për Punonjësit e Sektorit të Medias dhe Organizatat e Shoqërisë Civile Vendase dhe Ndërkombëtare

i) Ofrimi i mbështetjes së vazhdueshme me trajnime që mundësojnë rritje profesionale të punonjësve në sektorin e medias si dhe për ndërmarrjen dhe konkretizimin e një nisme serioze dhe të qëndrueshme, të organizimit sindikal të punonjësve të këtij sektori. Të dyja rekomandimet janë "të vjetra", por ato vijojnë të përmenden si nevojë nga vetë sektori, edhe pse hapat për t'i konkretizuar janë kompleksë dhe në këndvështrim makro situata nuk mund të ndikohet vetëm prej këtyre dy ndryshimeve.

Organizimi sindikal apo çdo formë tjetër organizmi mbrojtës do të ndihmonte në krijimin e një terreni më të sigurtë për "rebelime" ndaj praktikave abuzuese apo jo të drejta që ndiqen brenda redaksive dhe po ashtu në një përgjigje më të fortë ndaj presioneve që shtyjnë drejt joprofesionalizmit, mungesës së etikës e të ngjashme. Qartazi organizimi i punonjësve të medias në lëvizje sindikaliste nënkupton që vetë gazetarët/punonjësit e medias duhet të ndërmarrin nismën, për tu organizuar kolektivisht sipas parashikimeve të Kodit tonë të Punës. E njëjta qasje vlerësojmë se duhet të ndiqet edhe në raport të rritjes së kapaciteteve të punonjësve, një kërkesë periodike e cila duhet nxitur që të ngrihet nga ana e kërkuesve të saj, përpos projekteve dhe iniciativave të vazhdueshme që mund të ndërmarrë sektori i shoqërisë civile.

ii) Informimi dhe ndërgjegjësimi i vazhdueshëm i punonjësve të medias mbi të drejtat dhe liritë e tyre të lidhura me profesionin dhe lirinë e shprehjes, si dhe nxitja dhe mbështetja për të reaguar në rast të përballjes së tyre me kriza dhe sulme që cënojnë lirinë e medias e kuadrin ligjor mbi marrëdhëniet e punës, dhe synojnë vetë-censurën e censurën.

iii) Avancimi i mëtejshëm me nisma vetë rregulluese solide dhe impaktuese nga vetë punonjësit e sektorit të medias, kemi mendimin se do të kontribuojë pozitivisht në drejtim të forcimit të pavarësisë, integritetit, etikës dhe profesionalizmit të medias në vendin tonë.

iv) Përpos dëshirës dhe vullnetit vetjak të gazetarëve të angazhuar gjatë zbatimit të kësaj iniciative, jemi të mendimit se duhet vlerësuar kontributi i përfaqësuesve të sektorit të shoqërisë civile në vend dhe asaj ndërkombëtare në krijimin e mjedisve më të sigurta të punës për gazetarët dhe punonjës të mediave, elementë ndikues të drejtpërdrejtë në nxitjen e lirisë. Në tregun mediatik të sotëm në Shqipëri, ekspertët të fushës vlerësojnë se mundësitë më të mira dhe hapësirat më të lira e profesionale për gazetarët funksionojnë

[29] https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor_Te-drejta-pune-per-gazetaret_ALB-1.pdf

brenda këtyre OJF me financim kryesisht nga jashtë vendit dhe pa interesa direkte në politikën vendase.

v) Ofrimi i shërbimeve ligjore falas dhe solidaritetit profesional në rastet e shkeljeve të të drejtave të punonjësve të sektorit të medias, do të kontribuonte pozitivisht për të rritur aksesin e tyre në organet e drejtësisë si dhe për të krijuar modele apo praktika pozitive të mbrojtjes së lirisë së shprehjes në gjykatë. Për shumë gazetarë ndjekja e proceseve ligjore dhe përballimi i kostove të tyre është dekurajues dhe një prej shtysave për të pranuar kushte pune jo të mira dhe censurën apo aplikuar autocensurë.

Rekomandime për përfaqësuesit e organeve publike dhe partive politike

i) Të shmanget çdo formë e ndërhyrjes në kundërshtim me garancitë e nenit 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që garanton lirinë e shprehjes, veçanërisht kur këto vijnë nga ekzekutivi, legjislativi apo çdo përfaqësues i organeve publike si dhe përfaqësues të forcave politike në vend.

ii) Përpjekjet e reja për krijimin e një "agjencie informacioni", konteksti i të shprehurit dhe gjuha jo etike e përdorur ndaj gazetarë dhe medias, si dhe mungesa e komunikimit të drejtpërdrejtë me median, në formën e konferencave të shtypit e tryezave të përbashkëta të konsultimit, vlerësojmë se duhet të adresohen në vijimësi, në një proces që garanton dëgjesën dhe konsultimin efektiv të punonjësve të medias në vendin tonë.

iii) Centralizimi i informacionit nëpërmjet përfaqësuesve për median të institucioneve publike në nivel vendor dhe të përdorimit të mjeteve të komunikimit teknologjik (programe të individualizuara në rrjetet Facebook, Tëitter, Youtube etj)., të administruara nga ana e përfaqësuesve të pushtetit vendor, ka bërë që gazetarët e terrenit të njihen me lajmin nëpërmjet ofrimit të regjistrimeve në kaseta dhe CD, një prej elementëve që dëmton rëndë profesionalizmin dhe raportimin sidomos në fushata elektorale.

iv) Përpjekje konkrete duhet të realizohen nga ana e inspektoriateve (si Inspektorati i Punës (ISHPSHSH) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe agjencive të ngritura me synim monitorimin objektiv, të paanshëm dhe joselektiv si dhe në mënyrë rigoroze të zbatimit të kuadrit ligjor nga ana e entiteteve private dhe atyre publike.

v) Tregu i medias në Shqipëri është i përqëndruar ndjeshëm në duar të pak pronarëve të disa prej televizioneve kryesore që kanë shumicën e audiencës. Kështu rekomandimi i hershëm i bërë edhe nga Komisioni Evropian dhe OSBE, për rikthimin e kuotës tavan për aksionet në mediat audiovizive, mbetet kyç për të krijuar një treg më pluralist.

Aneks 1 - Pyetësor

Lista e indikatorëve:

Seksioni i parë do të përmbajë tetë pyetjet e mëposhtme:

Të drejtat në punë:

1) A punoni bazuar mbi një kontratë të rregullt pune?

   a) Po
   b) Jo
   c) Nuk e di

2) Kontrata juaj e punës është me afat apo pa afat?

   a) Me afat 1 vjeçar
   b) Me afat (specifiko)
   c) Pa afat

3) A e merrni të plotë pagën tuaj në bankë?

   a) Po
   b) Jo
   c) Nuk e di

4) Sa ditë në javë punoni?

   a) 5 ditë
   b) Më pak, specifiko
   c) Më shumë, specifiko

5) Sa ditë në vit merrni pushim?

6) A jeni ndjerë ndonjëherë i bullizuar/tallur në ambientin e punës?

   a) Po
   b) Jo

   Nëse po, specifiko

7) A jeni ngacmuar ndonjëherë seksualisht nga dikush, nga i cili keni pasur varësi profesionale në ambientin e punës?

a) Po
b) Jo
Nëse po, specifiko

8) A është e nevojshme që gazetarët të kenë një sindikatë që do të mbronte të drejtat e tyre në punë?

a) Po
b) Jo
c) Nuk e di

9) A do të ishit ju vetë pjesë aktive e kësaj sindikate?

a) Po
b) Jo
c) Nuk e di

Liria profesionale:

Seksioni i dytë do të përmbajë 13 pyetjet e mëposhtme:

1) A jeni ndjerë ndonjëherë i kërcënuar fizikisht si pasojë e punës tuaj?

a) Po
b) Jo
Nëse po, specifiko

2) A jeni kërcënuar ndonjëherë verbalisht si pasojë e punës tuaj?

a) Po
b) Jo
Nëse po, specifiko

3) A jeni ndjerë i mbështetur nga punëdhënësi juaj në rastet e kërcënimit si pasojë e punës tuaj?

a) Po
b) Jo
c) Nuk e di

4) A keni përjetuar ndonjëherë nivel të lartë stresi si pasojë e punës?

a) Po
b) Jo
c) Nuk e di

5) A keni mbuluar dhe raportuar ngjarje, të cilat ju kanë krijuar tronditje të fortë psikologjike?

a) Po
b) Jo
c) Nuk e di

6) A keni kërkuar ndonjëhere ndihmë mjekësore/psikologjike si pasojë e tronditjeve profesionale?

a) Po
b) Jo

Nëse po, specifikoni se ku.

7) A keni kërkuar ndonjëherë ndihmë nga ana e organizatave që mbrojnë të drejtat e mediave dhe gazetarëve për ndonjë situatë të pakëndshme që lidhet me punën tuaj apo profesionin?

a) Po
b) Jo

Nëse po, specifikoni se kur e keni kërkuar këtë nidhmë dhe a ju është dhënë ndihma që keni kërkuar.

8) A ju ka ndodhur që punëdhënësi t'ju ketë ndaluar direkt apo përmes eprorit tuaj të publikoni një lajm?

a) Po
b) Jo
c) Nuk e di

9) A ka pasur raste, kur jeni urdhëruar të lini përgjysmë hulumtimin e një ngjarjeje?

a) Po
b) Jo
c) Nuk e di

10) A ka pasur ndonjë rast kur ju është kërkuar të shkruani një lajm të rremë?

a) Po
b) Jo
c) Nuk e di

11) A ju ka ndodhur që të keni shmangur raportimin e një lajmi, sepse keni menduar se publikimi i tij nuk do t`i pëlqejë punëdhënësit/redaktorit tuaj?

a) Po
b) Jo
c) Nuk e di

12) A keni frikë se publikimi i një lajmi, që mund të mos i pëlqejë punëdhënësit/eprorit tuaj, mund t'ju pushojë nga puna?

a) Po
b) Jo
c) Nuk e di

13) A jeni tërhequr ndonjëherë nga hulumtimi/publikimi i një lajmi, nga frika se do të paditeni në gjykatë?

a) Po
b) Jo
c) Nuk e di

Vlerësimi mbi lirinë e medias:

Seksioni i tretë do të përmbajë 10 pyetjet e mëposhtme:

1) Sa të lirë e vleresoni median në Shqipëri në vitin 2020?

a) Plotësisht të Lirë
b) Të lirë
c) Mestarisht të lirë
d) Pak të Lirë
e) Aspak të lirë

2) Në raport me një vit më parë (vitin 2019) a mendoni se liria e medias:

a) Është përmirësuar
b) Është përkeqësuar
c) Nuk ka ndryshim

3) Nëse media për ju nuk është e lirë (mesatarisht, pak ose aspak e lirë), cilët janë faktorët kryesorë që pengojnë apo e cenojnë lirinë e medias? (zgjidh tre alternativa)

a) Ndërhyrjet e qeverisë apo partive politike
b) Interesat e bizneseve të drejtuara nga pronarët e mediave
c) Përdorimi i medias për t'u pasuruar
d) Bizneset të cilat reklamojnë në media
e) Krimi i organizuar
f) Faktorë të tjerë (specifiko)

4) Cilët janë faktorët që do të ndihmonin më shumë rritjen e lirisë së medias? (zgjidh tre alternativa)

a) Rritja e numrit të mediave në vend
b) Rritja e përgatitjes profesionale të gazetarëve
c) Krijimi i mediave në pronësi dhe drejtim të vetë gazetarëve
d) Krijimi i sindikatave në mbrojtje të gazetarëve
e) Mbështetja e mediave nga donacionet e huaja

f) Faktorë të tjerë (specifiko)

5) Në vlerësimin tuaj, cilat ishin një ose disa nga ngjarjet më të rënda që cënuan lirinë e medias përgjatë 2020-ës?

6) Në vlerësimin tuaj, cilat ishin disa nga zhvillimet të cilat i ndikuan rritjes së lirisë së medias përgjatë 2020-ës?

7) Cilët janë arsyet që pengojnë gazetarët t'i drejtohen gjykatës nëse liria e tyre e shprehjes cënohet: (zgjidh më shumë se një alternativë)

   a) Nuk ka asnjë arsye
   b) Mungesa e të ardhurave
   c) Burokracitë në përballjen me gjykatën
   d) Frika nga hakmarrja e punëdhënësit
   e) Frika se nuk do të punësohet nga punëdhënës të tjerë
   f) Të tjera (specifiko)

8) Si e vlerësoni praninë e gazetarisë profesionale (cilësore) në vend gjatë vitit 2020?

   a) Ka qenë më prezente në media
   b) Ka qenë më pak prezente në media
   c) Nuk ka ndryshuar

9) Çfarë mund të bëhet për të përmirësuar cilësinë e gazetarisë në vend?

10) Çfarë mund të bëhet për të pasur sa më shumë shkrime/kronika cilësore në media?